



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 14
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 4 prill 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Faton Topalli, dhe Fikrim Damka.

I ftuar: Uran Ismaili, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.3.2018;
3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili;
 - Adresimi i rekomandimeve të Raportit të Auditimit të performancës për efikasitetin dhe efektivitetin, në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor; Procesi i revidimit të listës esenciale të barnave;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.03.2018;

Komisioni miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes të mbajtur më 28.3.2018.

3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Uran Ismaili.

- **Adresimi i rekomandimeve të Raportit të Auditimit të performancës për efikasitetin dhe efektivitetin në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor;**
- **Procesi i revidimit të listës esenciale të barnave.**

Besa Baftiu, kryetare e Komisionit: Komisioni në mbledhjen e kaluar e ka shqyrtuar raportin e auditorit Auditimit të performancës për efikasitetin dhe efektivitetin në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor. Komisioni ka vendosur që të ju ftojë në raportim dhe të njoftohet me adresimin e rekomandimeve.

Në shkurt të vitit 2017, Kuvendi miratoi Rezolutën, e cila e obligon Zyrën Kombëtare të Auditimit, të bëjë auditimin SISH-it, prej fillimit të tij e deri në fund të vitit 2016. Në bazë të Rezolutës, ministri i MSH-së ka qenë i obliguar që në Kuvend të raportojë në baza të rregullta tremujore për funksionalizimin e SISH-it dhe tash ne jemi në mars të vitit 2018, ndërkohë që ju akoma s'keni raportuar para Kuvendit. Çka keni bërë rreth këtyre të gjeturave? A pajtoheni me këto të gjetura? A i keni adresuar rekomandimet? Në cilën fazë është sistemi i SISH-it? Kur do të përfundoj sistemi i SISH-it në tërë Kosovën?

Uran Ismaili : Sistemi i Informimit Shëndetësor është projekt që ka filluar kohë më parë, pra diku para shtatë vite dhe ka pasur përpjekje të shumta edhe nga ministrat e mëhershëm për të përfunduar këtë sistem. Projekti ka pasur pengesa të shumta gjatë tërë kohës. Ka pasur mungese të buxhetit, mungesë të stafit. Siç e potencuat, ka shumë rekomandime nga raporti i auditorit. Të cilat janë ndarë në grupime, si ajo e burimeve njerëzore, ndërlidhja e funksionimit të komiteteve, trupave të caktuara, mungesa e buxhetit, mungesa e trajnimeve, të cilat kanë rezultuar në keqmenaxhim të projektit. Ne kemi vlerësuar rekomandimet, mirëpo për t'i adresuar rekomandimet sa për adresim nuk kemi dashtë në atë mënyrë se vetëm e kishim dëmtuar projektin. Ne kemi dashur që të kemi një pasqyrë të qartë për adresim sa më të mirë të rekomandimeve. Pasi që i kemi edhe përkrahjen e donatorëve të cilët kanë investuar miliona euro në këtë sistem dhe nuk guxojmë të bëjmë diçka në mënyrë vetjake pa koordinim më donatorët, komunikimi me donatorët na kanë vonuar, na duhet një koordinim më i mirë me donatorët për hapat e ardhshëm më këtë projekt, në mënyrë që mos të tërhiqen donatorët.

Probleme pati edhe në burimet njerëzore. Departamenti ka pasur staf shumë të vogël për të zhvilluar këtë projekt kapital. Ne kemi diskutuar mirë me partnerë si Luksemburgun dhe Bankën Botërore për të ardhmen. Deri me tani ka qenë faza e parë si pilot projekt. Nga kjo fazë ne kemi mësuar shumë se ku kanë qenë gabimet. Kemi bërë një planifikim më të mirë si në financa pra buxhetin për harduer. Në të ardhmen do të kemi një bashkërendim më të mirë të aktivitetëve për ti pasur si softuerin, harduerin, stafin dhe buxhetin. Na duhet përkrahja e të gjithëve për këtë projekt që në dy apo tri vitet e ardhshme që të ndajmë buxhetin e mjaftueshëm për implementimin e këtij sistemi, po ashtu, nëse nuk mund të rrisim numrin e stafit, do të kemi probleme më implementim. Kanë qenë shtatë zyrtarë, kurse aktualisht janë dhjetë dhe jemi në procedura edhe për tre zyrtarë të ri. Ka nevojë për shtim të stafit edhe në të ardhmen.

Naser Rugova: Sot po diskutojmë për raportin e auditorit për SISH-in, i cili është njeri nga projektet kryesore që përmes tij sistemi shëndetësorë të marrë drejtimin e duhur dhe ti përcjell trendet normale të zhvillimit të sistemit shëndetësor. Auditori në mënyrë të shkëlqyeshme ka prezantuar të metat e këtij projekti dhe të cilat janë të qarta për ju për adresim për SISH-in dhe ne fund të kemi një sistem funksional, pa të cilin nuk do të kemi një sistem shëndetësorë kualitativ, përkujdeset në mënyrë të duhur për shëndetin e popullatës.

Disa nga konkluzat e raportit i adresohen MSH-së dhe pse tash shtatë vite dhe një pilot projekt që ka përfshirë vetëm 30% të territorit, nuk është funksional. LUX development ka investuar rreth 20

milione euro, janë shumë mjete dhe ne akoma s'e kemi funksional këtë sistem. Ju si ministër duhet të keni objektiva të qarta organizim dhe riorganizim të këtij departamentit të SISH-it, bashkëveprim me të gjitha institucionet që sa më parë të kemi një sistem funksional. Departamentit të SISH-it duhet ti ndahet buxhet i mjaftueshëm pasi që është prioritet strategjik i institucioneve tona. Në rishikim të buxhetit të kaluar dhe në shqyrtim të buxhetit 2018, kam kërkuar që të ndahen 100 milionë euro për shëndetësinë dhe të lihen pa u shtruar nga 5 kilometra të ndërës dhe tjetrës autostradë dhe të intervenohet në sektorin e shëndetësisë.

Time Kadrijaj: Komisioni ka shqyrtuar këtë raport të auditorit për projektin e SISH-it dhe ne kemi vërejtur dhe në atë që potencuat ju, ky projekt kapital që nga fillimi paska pasur predispozita për të dështuar. Për shkak se ne si Kosovë s'e kemi përgatitur infrastrukturën në mënyrën e duhur që ky projekt të sjellë rezultatet e duhura. Duke e parë fillimin e implementimit tash shtatë vite dhe në fund të rezultojë me një raport të performancës së tillë është tmerruese.

Janë investuar edhe miliona euro nga donatorët dhe në të ardhmen donatorët tjerë që do të shohin këtë raport, do të zbrapsen, pasi që do të kenë hezitimin tyre pse gjithë ky investim dhe ka dështuar projekti. Ne këtë raport janë prezantuar ngecjet, mangësitë të cilat duhet adresuar sa më parë nga ana juaj më një seriozitet të shtuar. Sistemi i SISH-it po ka lidhshmëri edhe me fillimin e funksionimit të sigurimeve shëndetësore.

Enver Hoti: Ne e kemi analizuar raportin, i cili ka përfshirë edhe menaxhimin e financave, 24 rekomandime që kanë dalë nga viti 2015 dhe sipas raportit të auditorit, dy janë zbatuar, 12 nuk janë zbatuar fare dhe 12 janë në proces. Kjo është një shenjë që tregon se punët nuk janë duke shkuar mirë. Pra, moszbatimi i rekomandimeve do të thotë nuk ka përmirësim të situatës. Sipas raportit sistemi i auditimit të brendshëm nga 11 planifikimet janë realizuar vetëm 8 dhe përcillet me mungesë të stafit dhe jo lëndët që do ti kontribuonin rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm. Njësia e auditimit të brendshëm nuk funksionon siç duhet dhe nuk ka plan paraprak që do ti ndihmonte menaxhimin të financave dhe qeverisjes së mirë të ministrisë së MSH-së. Çështje tjetër që është ngritur nga auditorët, është mbajtja e pozitave me U.D, pozita kyçe e që janë gjithsej 144. Janë mbi 2 milion euro të papaguara për furnitorët nga vitet 2016 dhe 2017 sipas raportit financiar. Nga ju kërkoj prezantimin e planifikimit për vitin 2019.

Haxhi Avdyli: Raporti i auditimit është një bazë e mirë për shikim të mangësive si dhe për gjetjen e zgjidhjeve për këto probleme. Përgjegjësi për dështimin e SISH-it si dhe për të gjitha dështimet në shëndetësi, janë të gjitha partitë politike. Ne raportimet e mëhershme keni prezantuar planet tuaja se kur do të filloni me sigurimet shëndetësore. Në këtë rast, a mendoni se sigurimet shëndetësore mund të fillojnë pa qenë funksional sistemi i SISH-it? Apo keni ndonjë plan tjetër? Kur do të filloni me sigurimet shëndetësore? Burimet njerëzore potencuat se i keni rritur. A mendoni që burimet njerëzore ti rrisni edhe nëpër institucionet tjera? A keni vazhduar me ofrimin e trajnimeve për stafin shëndetësorë për përdorim të sistemit? Cilat janë prioritetet apo kërkesat buxhetore për vitin 2019, konkretisht për SISH-in ?

Bekim Haxhiu: Raporti i auditimit ka nxjerr në pah atë që kemi deklaruar në vazhdimësi, pra është përgatitur një projekt i paimplementueshëm. Planifikimet jo të mira, miliona euro edhe s'janë shpenzuar si dhe ato që janë shpenzuar, janë keqshpenzuar. Ky projekt tash tetë vite ka filluar dhe akoma nuk dihet se kur do të përfundojë si dhe a mund të përfundojë. Përgjegjësi për dështim të këtij projekti ka, dhe ne si deputetë kërkojmë nga ju si ministër i MSH-së që këtë përgjegjësi për dështim ta adresoni.

Ne e dimë se janë blerë disa kompjuterë që janë shpërndarë nëpër disa klinika, të cilët nuk janë në shfrytëzim. MSH-ja duhet të marrë me seriozisht këtë projekt dhe t'ua bëjë me dije edhe

donatoreve se a janë të interesuar që të përbyllin, pra të ndihmojnë implementimin dhe ato zotime që i kanë dhënë.

Fatmire Kollçaku-Mulhaxha: Në bazë të rezolutës se kuvendit është përgatitur ky raport i auditimit për SISH-in si njëri nga projektet kapitale, i cili po paraqitet si pengesë kryesore në fillimin e implementimit të sigurimeve shëndetësore. Në mungesë të SISH-it, ne nuk e kemi një pasqyrë reale të sëmundjeve në Kosovë. MSH-ja duhet të dalë me një qëndrim, në lidhje me të gjeturat e auditorit. Ministër, s'mund të kalojmë në fazën e dytë pa dhënë përgjegjësi për këto abuzime që kanë ndodhur me këtë projekt.

Për të funksionuar sistemi i SISH-it, duhet ta kemi edhe infrastrukturën e rregulluar. Ne si Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike, ende pranojmë raporte në hard copy, raportimet bëhen përmes letrave. Në këtë rast, sistemi i SISH-it as si pilot projekt nuk është përmbushur apo nuk është funksional.

Flora Brovina: Ne po diskutojmë për punën e ministrave të kaluar, pasi që raporti i auditorit ka bërë auditimin e punës së mëhershme rreth sistemit të SISH-it. Buxheti nuk është shpenzuar për sistemin e SISH-it, por për gjëra tjera, blerje të pajisjeve aparatura. Ne këtë rast për funksionim të sistemit të SISH-it duhet të jenë funksionale edhe odat e profesionistëve shëndetësorë.

Besa Baftiu, kryetare: Në bazë të të gjeturave të raportit të auditorit për SISH-in, shihet se ka pasur keqpërdorim apo keqmenaxhim të buxhetit të SISH-it. Pra, të gjithë e dimë se SISH-i është parakusht për implementimin e sigurimeve shëndetësore. Sipas raportit del se mjetet nuk janë shpenzuar të gjitha për implementimin e SISH-it, mirëpo, janë shfrytëzuar për çështje të tjera. Pra, 76% e pagesave janë realizuar për aktivitetet e ndërlidhura me SISH-in, ndërsa 24% të pagesave, që në vlerë financiare është 417 mijë euro, janë realizuar për projekte të tjera, të cilat nuk ishin paraparë me projektin e SISH-it. Për më shumë, nga buxheti i SISH-it janë kryer pagesat për: vendime gjyqësore në vlerë prej 201 mijë euro, 77 mijë euro për furnizim me Rëntgen në QKUK, 59 mijë euro për furnizim me “Digital ultrasound imaging system”, 70 mijë euro për “përpilim i termave të referencës, projektit ideor dhe renovim dhe sanim i ashensorëve në QKUK” dhe 9 mijë euro, për “integrimin e bazës së të dhënave në portalin e E-Qeverisjes”. Mosimplementimi i SISH-it, del se ka qenë si pasojë e mosmenaxhimit të mirë nga MSH-ja dhe ne ende nuk e kemi një raport të detajuar se pse ka dështuar funksionalizimi i këtij sistemi.

Uran Ismaili: Deri me tani për sistemin e SISH-it janë ndarë buxhet 6.8 milion, pra kjo është shifra zyrtare sa i përket LUX development. Për implementimin e SISH-it ka nevojë për staf edhe buxhet shtesë, pa këto dyja, ky projekt nuk mund të funksionalizohet.

Ne kemi përgatitur dy plane të veprimit për Sistemin e Informimit Shëndetësor –SISH dhe i kemi dorëzuar në Bankën Botërore, një plan për 12 muaj një për 18 muaj dhe jemi duke pritur përgjigje. Pse nuk i kemi adresuar shumë rekomandime, kanë qenë për shkak planit të veprimit. Në planin e veprimit janë përfshirë edhe revidimi i termave të referencës, ekspertin që do të bëjë revidimin, janë përfshirë kontraktimi, blerja dhe implementimi, pra janë të parapara të gjitha veprimet apo aktivitetet që i kemi dorëzuar në Bankën Botërore. Nëse na financojnë mirë, nëse jo ne duhet të vendosim si t'ia bëjmë, a duhet më nda buxhet edhe staf shtesë dhe të përbyllet ky projekt. Plani i veprimit përfshinë për gjitha fazat e implementimit dhe në tërë territorin e Kosovës. Koston jemi duke e pritur të dalë në bazë të aktiviteteve edhe periudhës si dhe çfarë sistemi vendosim.

Sa i përket lidhshmërisë së sistemit të SISH-it me sigurimet shëndetësore, është konsideruar se duhet ti kemi dy sisteme të ndryshme, pra të ndara. Nuk është kusht që të kemi sistemin e SISH-it funksional në momentin që të fillojmë me sigurimet shëndetësorë, pra është mirë, por jo kusht.

Sigurimet shëndetësorë mund të arrijnë, mirëpo e kemi një tjetër parakusht, pra Sistemi Informativ i Fondit –SIF. Këto dy sisteme integrohen njëra me tjetrën. SIF është pa të cilën nuk mund të kemi sigurimet shëndetësorë. Përmes këtij sistemi, SIF-it po besoj do të arrijmë me shpejt të fillojmë me sigurimet shëndetësore sesa të funksionalizohet SISH-i, pasi që SISH-i është program menaxherial më tepër për spitalet, institucionet shëndetësore. Sa i përket planeve për vitin 2019, ne presim ndryshime të mëdha në furnizimin më barna, pra diçka që na ka kushtuar dhe po na kushton shumë dhe ne përsëri nuk kemi furnizim të mirë dhe në këtë rast më së shumti po pësojnë pacientët dhe stafi shëndetësorë.

Po ashtu, do të kemi ndryshim për të mirë me furnizimin me pajisje mjekësore. Për herë të parë menaxhementi i SHKUK-së ka vizituar secilën klinikë dhe ka marre nevojat e tyre apo prioritetet e klinikave që janë të mundshme për tu adresuar. Po ashtu, do të kemi një kategorizim të pagave për profesionistët shëndetësorë. Sa i përket odave të profesionisteve shëndetësorë, ne jemi duke i bartur përgjegjësitë tek Odat.

Haxhi Avdyli: Ju thatë ministër se mund të fillojnë sigurimet shëndetësore edhe pa SISH-in. Mendoj se mund të fillojë mbledhja e premieeve pa SISH-in, por zbatimi i sigurimeve shëndetësore mendoj se ka me dështuar. Nëse nuk e kemi SISH-in funksional, do të shtohet mundësia e manipulimeve dhe e keqpërdorimit të sigurimit shëndetësor. Nëse e keni në plan ti funksionazlizoni sigurimet shëndetësore pa SISH-in, mendoj se do të shkojmë drejt dështimit.

Kryetarja: Këtë përgjigje të njëjtë e kemi pasur edhe nga ish- ministri Rrahmani, i cili ka thënë se do të fillohet me sigurime shëndetësore pa funksionalizim të SISH-it, por me të cilin konstatim unë nuk jam pajtuar sepse mund të ketë keqpërdorim, dhe rritje të shërbimeve.

Flora Brovina: Sistemi shëndetësor publik dhe privat janë të barabartë, edhe te sigurimet shëndetësore, sigurimi privat duhet të jetë i barabartë me atë publik. Sigurimi shëndetësor privat ekziston si sigurim plotësues, dhe duhet të ketë një bashkëpunim në mes tyre.

Uran Ismaili: Mundësia e manipulimit ekziston gjithmonë, dhe asnjë sistem nuk është plotësisht i sigurt, por ka mënyrë të mbikëqyrjes dhe se çdo ndërhyrje len gjurmë se kush e ka keqpërdor. Ndërsa, mbledhja e premieeve do të fillojë vetëm kur të kemi mundësi ti zbatojmë sigurimet shëndetësore dhe qytetarët të marrin shërbimet për të cilat paguajnë.

Sistemi informativ i fondit është autonom dhe funksionon, i veçantë nga SISH-i. Do ketë edhe mbikëqyrje dhe auditim strikt të fondit të sigurimeve shëndetësore.

Sa i përket pakos bazike të shërbimeve, e kemi bërë edhe çmimoren dhe tani do ta bëjmë vetëm revidimin, dhe nëse shkon në një klinikë do ta dish se cilat janë shërbimet që do ti marrësh.

Sllovenia ka pakot e veta dhe bën koncesion me disa klinika private për shërbimet të cilat ka mbingarkesë të pacientëve.

Në takimet e radhës do t'ju njoftojë me hapat që i kemi marrë dhe deri ku ka arritur procesi i sigurimeve shëndetësore.

Bekim Haxhiu: Sigurimet shëndetësore funksionojnë edhe pa SISH-in, por për të qenë më të mira duhet të implimentohen dy sistemet njëkohësisht edhe Sistemi i Fondit edhe SISH-i, dhe mundësia e keqpërdorimeve do jetë më e vogël. Por pasi SISH po ka vështirësi të zbatohet, atëherë të vazhdohet me sigurimet shëndetësore, pavarësisht funksionimit të SISH-it.

Te kategorizimi i pagave, duhet të bëhet nivelizimi, kategorizimi dhe pagesa në bazë të performancës, sepse tani mjekët në një spital nuk paguhen njëjtë me mjekët e një spital tjetër edhe pse kryejnë punën e njëjtë.

Te odat e mjekëve, duhet tu krijohet hapësirë e punës. Odave nuk iu është alokuar buxhet, dhe mjekët nuk po kanë mjete për trajnime dhe edukim të vazhdueshëm. Odat duhet të funksionalizohen dhe ti marrin kompetencat e tyre.

Gjithashtu, kërkoj që në pakon e ndryshimeve ligjore të përfshihen edhe Ligji i Odave dhe Ligji për transplantimin e organeve.

Besa Baftiu, kryetare: Ne i kemi caktuar pikat e diskutimit, por shëndetësia ka shumë probleme, dhe ne po diskutojmë edhe jashtë pikave të rendit të ditës.

Si pikë të veçantë për të diskutuar sot e kemi edhe çështjen e revidimit të listës esenciale të barnave, revidim i cili nuk ka ndodhur që nga viti 2012. Revidimi i kësaj liste duhet të ndodh së paku çdo dy vjet.

Ne, nga përvojat e mëhershme nuk kemi qenë të kënaqur me barnat e përfshira në listën esenciale, dhe se revidimi i kësaj liste është bërë në bazë të interesave të kompanive farmaceutike, e jo sipas nevojave të qytetarëve. Presim që të ketë transparencë dhe bashkëpunim në revidimin e listës esenciale të barnave. Çfarë keni ndërmarr ju ministër dhe a jeni konsultuar me ekspertë dhe me klinikat që merren me këto çështje?

Uran Ismaili: Revidimi i listës esenciale të barnave është një proces që ka pasur interesa të shumta dhe ka pasur influencë edhe nga mjekët. Lojaliteti i mjekëve ndaj kompanive farmaceutike është i madh, prandaj kemi kërkuar nga OBSH-ja të na ndihmojnë në këtë proces. Shpesh mungesa e barnave lidhet edhe me revidimin e listës esenciale. Ky proces ka pas probleme dhe ky proces e ka rrënuar sistemin shëndetësor.

Nga OBSH-ja kemi kërkuar të na ndihmoj në revidimin e listës esenciale të barnave dhe të na ndihmoj në hartimin e një udhëzimi administrativ, i cili do të përcaktojë mënyrën e blerjes dhe çmimoren për blerje. Jemi dakorduar të caktojmë kritere dhe të vendosim terma të referencës dhe të punojmë shumë në shmangien e konfliktit të interesit. Përgjegjësit për revidimin e listës esenciale të barnave duhet ta nënshkruajnë një deklaratë nën betim se nuk kanë konflikt interesi në këtë proces. Nëse vërtetohet se ka pas konflikt interesi do të përgjigjen. Procesi ka filluar dhe ka pas takime të shumta me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Fokus kryesor e kemi pas revidimin e listës dhe prokurimin, dhe ta ndreqim një herë e mirë këtë proces. Do ta themelojmë edhe një komision të pavarur, i cili do ti analizojë të dhënat klinike, do ti analizojë të dhënat farmako- ekonomike dhe analizat e ndikimit në buxhet. Kjo është një punë komplekse dhe do të merren parasysh të gjithë faktorët e nevojshëm për revidim të listës. Do ketë referenca shkencore, referenca ndërkombëtare, referenca kimike, kosto efektive, referenca të udhëzimeve, ku është përdor etj. E gjithë kjo kërkon vështrim neutral dhe për këtë kemi kërkuar ndihmë nga OBSH-ja.

Udhëzimi administrativ për çmime të barnave është përfunduar. Ka pas raste ku kemi pas probleme edhe me projekte të donatorëve, por ka projekte ku pa ndihmën e donatorëve nuk mund ti realizojmë, e projekti i revidimit të listës esenciale të barnave nuk do të mund të realizohej pa mbështetjen e OBSH-së, prandaj i falënderoj për mbështetjen.

Besa Baftiu, kryetare: E dimë se për revidimin e listës esenciale të barnave janë shumë të rëndësishme protokollet klinike dhe deri me tani shumica e klinikave punojnë pa protokolle, që do të thotë se trajtimi i sëmundjeve nuk bëhet sipas protokolleve dhe në bazë të protokolleve do të revidohej edhe lista. A është duke u punuar në hartimin e protokolleve, që çdo klinikë ti ketë protokollet e tyre?

Uran Ismaili: Janë dy çështje të ndara, për revidimin e listës esenciale, është mirë të ekzistojnë protokollet por nuk është e domosdoshme. Janë 6 protokolle, jemi duke punuar në hartimin e 11

protokolle, jemi duke punuar por revidimi i listës esenciale e kjo do të ndodh edhe pa hartimin e të gjitha protokolleve.

Enver Hoti: Ne mbështesim aktivitetin tuaj që të bëhet revidimi i listës esenciale të barnave. Kam disa pyetje, e para sa ndahet buxhet për listën esenciale të barnave? Mosfunksionimi i SISH-it paraqet pengës edhe në furnizimin me barna. A ka të dhëna që nga barnat e listës esenciale, a ka stoqe të barnave me afat të skaduar dhe çfarë ndodh me to?

Fatmire Mulhaxha Kollçaku: Ne e kemi vështirë të bazohemi në protokollet e OBSH-së sepse ne kemi vështirësi edhe financiare dhe e kemi problem të fillojmë me një trajtim e to mos i kemi barnat e duhura, të përfundojmë me trajtimin e filluar.

Duhet t'i kemi protokollet tona e të punojmë në bazë të atyre protokolleve dhe ti kemi edhe barnat e nevojshme.

Edhe te funksionimi i sigurimeve shëndetësore private, ashtu si nuk ka mbikëqyrje të shëndetësisë në sektorin privat, ashtu nuk ka edhe mbikëqyrje të sigurimeve shëndetësore private.

Time Kadrijaj: Unë kërkoj që sa më shpejt të procedohet për Kuvend Projektligji për transplantim të organeve sepse është një ligj i domosdoshëm për qytetarët e Kosovës. Gjithashtu kërkoj që përveç revidimit të listës esencialet ketë edhe furnizim më të mirë me barna nga lista esenciale ekzistuese.

Bekim Haxhiu: A ka ndonjë hap të marrjes në përgjegjësi të atyre që kanë keqmenaxhuar me kontratat e barnave dhe tani 8 muaj kemi mungesë të barnave nga lista esenciale?

Mendoj që lista esenciale të hartohet në bashkëpunim me OBSH-në, por në hartimin e saj të përfshihen gjithësi konsiliumet e të gjitha klinikave. Listat duhet të përpilohen në bazë të kërkesave dhe nevojave të klinikave, por për të funksionuar mirë, duhet të bëhet edhe digjitalizimi i shpërndarjes së barnave.

Uran Ismaili: Buxheti për barna nga lista esenciale është 7 milion euro për shëndetësinë primare dhe 26 milionë euro për sekondaren dhe terciaren. Problemi i stoqeve, ka stoqe nga e kaluara, por sa jam unë ministër nuk ka shumë barna me afat të skaduar. Nuk ka stoqe të barnave të mbetura këtë vit sepse nuk ka pas as barna. Kanë skaduar kontratat dhe nuk ka qenë një person përgjegjës i cili i ka përcjell skadimin e kontratave. Ne kemi përfunduar udhëzimin administrativ për prokurim, jemi duke punuar ne revidim të listës esenciale të barnave, shpërndarja dhe përdorimi do të jenë pikat e radhës, në të cilat ne do të punojmë.

Sa i përket protokolleve, ne nuk jemi duke improvizuar, është mirë që ti kemi protokollet, por revidimi i listës esenciale mund të bëhet edhe pa pasur protokollet. Mirë do ishte ti kemi protokollet, por nuk është e domosdoshme.

Sa i përket përfshirjes së konsiliumeve të mjekëve në hartimin e listës esenciale të barnave, ne kemi rekomandim edhe nga OBSH-ja që të kemi sa më shumë konsultime dhe gjithëpërfshirje dhe të eliminohet edhe konflikti i interesit.

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku: Ta ndajmë çështjen e protokolleve nga lista esenciale, por çfarë po bëhet për hartimin e protokolleve?

Uran Ismaili: Deri më tani i kemi pas vetëm 6 protokolle. Këtë vit i kemi edhe 11 të reja. Jemi duke punuar në vazhdimësi që të përshpejtohet hartimi i protokolleve.

Sa i përket Ligjit për transplantim të organeve, do ta shohim procesin ku ka ngecur dhe do t'ju njoftojë në takimet e radhës.

4. Të ndryshme.

Kryetarja: Nga buxheti i ndarë për punën e Komisionit, të mbulohen shpenzimet për drekë punë të grupit punues për monitorimin e Ligjit për Shërbimet sociale familjar në kuadër të vizitës në Qendrës për Punë Sociale dhe strehimores „Shtëpia Ime” Ferizaj.

Naser Rugova : Propozoj që në mbledhjen e radhës të ftohen Shoqata e pacientëve me fibrozë cistike.

Kryetarja, konstatoi që në mbledhjen e radhës të ftohet kryeshefi i AKPM-së dhe shoqata e fibrozës cistike.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU